



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 prill 2022
Nr.ref.:RK 1985/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI220/21

Parashtrues

Besim Smajli

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev.nr.74/2021, të 15 korrikut 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Besim Smajli, i përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese nga avokati Vehbi Beqiri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.74/2021] të 15 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 30 gusht 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 13 dhjetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës e dërgoi në Gjykatën Supreme.
8. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Mitrovicë për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 15 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

10. Më 17 dhjetor 2021, Gjykata Themelore në Mitrovicë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
11. Më 31 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 31 maj 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës kishte nxjerrë Vendimin [31/SP/DP/2011] për suspendimin me pagesë të parashtruesit të kërkesës, pjesëtar i Policisë së Kosovës, për faktin se ishte subjekt i hetimeve për shkelje të Ligjit për Policinë.
13. Pas Vendimit të lartcekur, ndaj parashtruesit të kërkesës, paralelisht, u iniciua procedurë penale e cila përfundoi me shpalljen e tij si të pafajshëm.

Përmbledhja e fakteve në procedurë penale

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 30 nëntor 2011, Prokuroria Speciale ngriti Aktakuzën [PPS.nr.70/10] kundër parashtruesit të kërkesës dhe disa zyrtarëve të tjerë policorë, për shkak të dyshimit të bazuar se kishin kryer veprën penale “Shpërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar” nga neni 339, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), dhe “Marrja e ryshfetit” nga neni 343, paragrafi 1 të KPRK-së.
15. Më 15 shkurt 2013, duke vendosur sipas Aktakuzës [PPS.nr.70/10] së Prokurorisë Speciale, Gjykata Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [P.nr.22/12] e shpalli të pafajshëm parashtruesin e kërkesës, aktgjykim ky i cili u vërtetua nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.347/13] të 18 gushtit 2015.
16. Më 29 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK) kërkesë për dëmshpërblim për shkak të privimit të pabazë nga liria gjatë mbajtjes në paraburgim prej 9 ditësh. Në këtë drejtim, më 26 janar 2016, pas ofrimit të ujdisë nga Komisioni për Kompenzimin e Dëmit Personave të Dënuar pa arsye dhe Personave të Hequr Pabazë nga Liria, parashtruesi i kërkesës u kompensua në vlerë totale prej 108 euro.

Përmbledhja e fakteve në procedurë disiplinore

17. Më 17 korrik 2013, Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës përmes Vendimit [580/K8D/2013] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkelje disiplinore nga Kreu II, neni 5, pika 12 (*Sillet në mënyrë të tillë duke i vënë hije të keqe apo të turpshme Policisë së Kosovës gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj*), neni 8, pika 1 (*Në cilësinë e zyrtarit policor apo stafit civil të Policisë së Kosovës dhe pa autorizim përkatës në mënyrë direkte ose indirekte kërkon ose pranon*

ndonjë të mirë materiale, dhuratë, çfarëdo shërbimi, nënshkrimi apo rekomandimi) të Udhëzimit Administrativ Nr. 1512008-MPB, lidhur me nenin 46 pika a dhe d të Ligjit për Policinë.

18. Përmes Vendimit të lartpërmendur, parashtruesit të kërkesës iu shqiptua masa disiplinore *"Ndalesë në pagë 30% për 2 muaj nga paga bruto"* si dhe masa plotësuese *"Transfer Administrativ"*. Vendimi i lartcekur u vërtetua në shkallë të dytë nga Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime i Policisë së Kosovës.

Përmbledhja e fakteve në procedurë civile

19. Më 25 maj 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, për kompensimin e pagave të ndaluara nga 30 maji 2011 e deri më 2 prill 2013, në shumë prej 10.000 euro, dhe me kamatë ligjore prej 3.5.%.
20. Më 15 shkurt 2017, përmes Aktvendimit [C.nr.298/2016] të Gjykatës Themelore, dhe në bazë të deklaratës së ekspertit, shuma totale për kompensim, pa kamatë ligjore, u përcaktua të jetë 7,192.50 euro.
21. Në përgjigjen në padi, e paditura kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës në procedurë disiplinore ishte shpallur fajtor nga të dy shkallët, dhe vendimi i fundit, respektivisht ai i shkallës së dytë, nuk ishte kundërshtuar asnjëherë nga parashtruesi. Tutje, e paditura gjithashtu theksoi se kërkesa ishte parashkruar marrë parasysh se aktgjykimi në procedurë penale ishte nxjerrë me 15 shkurt 2013 ndërsa gjykatës i ishte drejtuar me 25 maj 2016, pas kalimit të afatit 3 vjeçar.
22. Më 29 shtator 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.298/2016] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave të ndaluara në bazë të vendimit mbi suspendimin me pagesë pasi që ishte paraqitur pas kalimit të afatit 3 vjeçar.
23. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kompensim të shumës që i ishte ndalur si rezultat i suspendimit me 50% të pagës, meqenëse ishte shpallur i pafajshëm në procedurë penale, në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore u vlerësua se parashtruesit të kërkesës nuk i takon e drejta e kompensimit të pagës që i ishte ndaluar pasi që në procedurë disiplinore ishte shpallur fajtor, pa marrë parasysh faktin se në procedurë penale ishte shpallur i pafajshëm.
24. Tutje, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.298/2016], vlerësoi se suspendimi nga puna me pagesë mund të bëhet për një periudhë maksimale prej 6 muajsh ndërsa në rastin konkret parashtruesi i kërkesës ishte suspenduar nga data 31 maj 2011 e deri më 28 shkurt 2013, përkatësisht për 20 muaj, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit të Punës. Gjykata Themelore konstatoi se vendimet e të paditurës në procedurë disiplinore ishin nxjerrë pas kalimit të periudhës 20 mujore

në suspendim, mirëpo meqenëse parashtruesi i kërkesës nuk i kishte atakuar këto vendime ajo nuk kishte kompetencë për të bërë shqyrtimin e tyre.

25. Për sa i përket parashkrimit të kërkesës, Gjykata Themelore specifikoi se në rastin konkret afati ka filluar të rrjedhë në momentin kur ka kaluar afati 6 mujor nga suspendimi, e që është data 1 dhjetor 2011. Meqenëse kërkesat në para parashkruhen brenda 3 viteve sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, sipas vlerësimit të Gjykatës Themelore afati i fundit për parashtrimin e padisë ishte 1 dhjetori 2014. Në këtë drejtim, në arsyetim të Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore vlerësoi se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padinë me 25 maj 2016, më tepër se 1 vit pas kalimit të afatit.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë pranë Gjykatës së Apelit, kundër Aktgjykimit [C.nr.298/2016] të Gjykatës Themelore, të 29 shtatorit 2017, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përmes ankesës, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim apo që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet duke e miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
27. Në ankesën e dorëzuar pranë Gjykatës së Apelit, lidhur me shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, parashtruesi i kërkesës pretendoi se dispozitivi i Aktgjykimit të ankimuar ishte i pakuptueshëm dhe se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me refuzimin e padisë dhe parashkrimin e kërkesës ishte kundërthënës. Në anën tjetër, përkitazi me pretendimin për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata Themelore nuk kishte vërtetuar drejtë faktin se lënda kishte qenë në procedurë penale nga data 6 maj 2011 e deri më 20 tetor 2015 dhe rrjedhimisht nuk mund të parashkruhej. Në lidhje me procedurën disiplinore kundër parashtruesit, ky i fundit në ankesën e tij theksoi se gjykata provat e ofruara i kishte vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Përfundimisht, sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale pasi që nuk i kishte aplikuar fare dispozitat e KPRK-së, Ligjit të Punës si dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
28. Më 8 shtator 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [A. nr. 5433/2017], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.298/2016] e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit në arsyetim të vendimit të saj shtoi se Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Themelore ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe nuk ishte përcjellë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.
29. Pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak se dispozitivi i Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ishte i pakuptueshëm dhe arsyetimi ishte kundërthënës, Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar duke konstatuar se Aktgjykimi i ankimuar ishte hartuar sipas

dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me një dispozitiv të qartë e të ekzaminueshëm. Për më tepër, lidhur me kundërthëniet në pjesën e arsytimit, në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit u theksua se pjesa e arsytimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ofronte arsye të kuptueshme për faktet vendimtare që çuan në përfundimin se kërkesëpadia duhet refuzuar. Tutje, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e provave kishte administruar të gjitha provat e prezantuara nga palët ndërgjyqëse.

30. Për më tepër, në arsyetimin e Aktgjykimit [A. nr. 5433/2017] të Gjykatës së Apelit u theksua se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që parashtruesi i kërkesës të kërkojë kompensim pasi që nuk ka inicuar procedurë kontestimore për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Komisionit Disiplinor për ndalesën në pagë. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit, gjithashtu vlerësoi se në procedurë disiplinore ishte vërtetuar përgjegjësia disiplinore e parashtruesit të kërkesës për shkelje të rënda të detyrave të punës dhe se shpallja e parashtruesit si jo-faktor në procedurë penale nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore dhe as nuk krijon bazë juridike për kompensimin e diferencës në pagë si rezultat i vendimit të punëdhënësit, vendim ky i cili nuk i është nënshtruar asnjëherë shqyrtimit gjyqësor.
31. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [A.nr.5433/2017] të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe tejkalim të kërkesëpadisë. Përmes revizionit, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, respektivisht shkelje të nenit 182, paragrafi 2, pika n të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që sipas tij dispozitivi i Aktgjykimit ishte i pakuptueshëm për faktin se objekt i kërkesëpadisë ishte që gjykata të vërtetojë faktin se paditësi ishte suspenduar në mënyrë të kundërligjshme nga puna me pagesë 50% nga data 30 maj 2011 deri më 2 prill 2013, kur pas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të 15 shkurtit 2012 ishte shpallur i pafajshëm. Kësisoj, parashtruesi i kërkesës, në revizionin e dorëzuar në Gjykatën Supreme, ka specifikuar se ka qenë në proces gjyqësor penal nga 26 maji 2011 e deri më 20 tetor 2015, kur e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës iu referua nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore me pretendimin se kjo dispozitë lidhë rastin penal si parakusht për të vërtetuar ekzistimin e dëmit civil dhe se për më tepër sipas nenit 361 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kur ka vendim të plotfuqishëm afati i kërkesës është 10 vjet.
32. Më 15 korrik 2021, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.74/2021], e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke i pranuar qëndrimet juridike të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë si dhe konstatoi se Aktgjykimet e tyre nuk ishin përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që kërkesa ishte parashkruar.

33. Pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 182, paragrafi 2, pika n të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar duke vlerësuar se çështja e gjykimit në procedurë penale dhe çështja para organit të administratës në procedurë disiplinore janë të ndara plotësisht nga njëra tjetra, nga ku rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte shpallur i pafajshëm vetëm në procedurë penale dhe jo në atë disiplinore.
34. Në fund, pretendimin e parashtruesit të kërkesës se kur ka vendim të plotfuqishëm afati i parashkrimit që buron nga i njëjti është 10 vjet, Gjykata e vlerësoi si të pambështetur meqenëse sipas arsyetimit të Gjykatës Supreme neni 87 i Ligjit të Punës përcakton në mënyrë të qartë se *“të gjitha kontestet nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) viteve nga paraqitja e kërkesës”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se arsyetimi dhe dispozitivi i gjykatës për padi të pasafatshme është në kundërshtim të plotë me njëri tjetrin duke theksuar se ai ka qenë i përfshirë në procedurë penale nga 26 maji 2011 deri më 20 tetor 2015 kur e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, me të cilin u shpall i pafajshëm. Sipas parashtruesit të kërkesës, menjëherë pas pranimit të aktgjykimit të lartpërmendur, ai i është drejtuar Sekretariatit të KGJK-së për kompensim, dhe pasi që ky kompensim nuk iu ofrua në tërësi, ai parashtroi padi në Gjykatën Themelore për kompensimin e pagave të ndaluara përmes Vendimit [31/SP/DP/2011] të Policisë së Kosovës, nga 30 maji 2011 e deri më 2 prill 2013, padi që sipas parashtruesit të kërkesës u dorëzua pa kaluar as 3 muaj. Për sa i përket pretendimit për kundërthënie në aktgjykimin e gjykatës, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Kunderthenja e arsyetimit të aktgjykimit bie ndesh në cdo paragrafte arsyetimit të te nejtut. Gjykata në faqe 3 të aktgjykimit paragrafi i fundit konstaton citoj” “Paditesi vetëm në procedurë penale është shpallur i pafajshëm e jo edhe në procedurë disiplinore ” Ku e bazon gjykata këtë konstatim ndaj një vendimi të gjykatës penale që i ka kaluar të gjitha instancat dhe paditesi ka dalë i pafajshëm. Prapëse rast se i referohet masës disiplinore për dy muaj me nga 30% ndalesë ajo nuk ka qenë objekt padie e as kërkesëpadie”*.
37. Tutje, parashtruesi i kërkesës, për sa i përket tejkalimit të kërkesëpadisë nga gjykata, thekson se:

“Gjykata ne arsyetimin e vet ka dhene nje vleresim kontradiktor nga se Padia dhe Kerkespadia nuk ka qene e ushtruar per siq thuhet ndalesen 30% per dy muaj. Kjo nuk ka qene pjese e padis dhe kerkespadis andaj edhe gjykata nuk ka pase nevoj te nderlidhe kete pa qene objek i padise.”

Paditesi si ne padi ka kerkuar pjesen epa paguar te kohes sa ishte ne suspendim me pages 50% gjate kohes sa esht zhvilluar procedura penale ndaj tij. Suspendimi eshte bere mbi bazen e paraburgosjes se tani paditesit dhe se ka qene i lidhurrn me rastin penal. Se ka qene i kunderligjshem kete e ka vertetuar Gjykata me Aktgjykimin e saj penal.”

38. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për arsye se gjykata nuk ka marrë parasysh faktin se ai është shpallur i pafajshëm në fund të procesit gjyqësor dhe se gjykata nuk e ka vërtetuar faktin se që nga data e arrestimit, konkretisht nga 6 maji 2011 e deri me 20 tetor 2015, lënda ka qenë në procedurë penale dhe nuk ka mundur të parashkruhej. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton se gjykata gabimisht ka aplikuar apo nuk ka aplikuar fare dispozitat ligjore të KPRK-së, Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligjit të Punës, Kushtetutës së Kosovës si dhe Konventave Evropiane lidhur me të drejtën e rehabilitimit të personave të akuzuar padrejtësisht dhe të liruar nga gjykata me aktgjykim të plotfuqishëm.
39. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se me anë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë si në vijim:

“Shkelje te nenit 24 te Kushtetutes se Republikes se Kosoves -Barazia para ligjit, me faktin se parashtruesit i jan mohuar nga gjykata civile dispozitat te cilat burojn nga kushtetuta dhe te drejtat qe pas nje procesi gjyqesor i takojne te liruarit nga akuza te cekura si me aktet si me lart: Kodi i Procedures Penale, Ligji i punes, Ligji i Procedures Kontestimore.

-Shkelje e nenit 29 pika 1 dhe 5 te Kushtetues se Republikes se Kosoves - E drejta e lirise dhe sigurise, e qe kjo dispozite ka kuptimin e sigurise se qytetareve para ligjit ne rastet e kompensimit te personave te akuzuar padrejtesisht.

-Shkelje e nenit 32 te Kushtetutes se Republikes se Kosoves- E drejta per mjete juridike, pra parashtruesi menjehere pas perfundimit te rastit penal ne afatin ligjor i eshte drejtuar gjykates civile por se e njehta pa baze e ka kontestuar afatin 3 vjeçar nga aktgjykimi penal i plotfuqishem dhe e ka refuzuar padine si te pasafateshme. Sipas vleresimit tone edhe padia duhet konsideruar si mjet juridik qe i eshte mohuar Parashtruesit nga gjykata civile.

-Shkelje te nenit 54 te Kushtetutes se Republikes se Kosove- Mbrojtja gjyqesore e te drejtave, e qe sipas parashtruesit gjykata civile ka deshtuar te mbroj te drejtat e kane buruar nga gjykata penale ne rastin e njejte.

-Shkelje te nenit 55 te Kushtetutes se Republikes se Kosoves- Kufizimi i lirive dhe te drejtave themelore, rrjedhe per faktin se parashtruesit i jane kufizuar te drejtat

per pune dhe kompensim te ardhurave personale per kohen sa ishte i akuzuar dhe

kjo e drejt themelore nuk i eshte njohur per kohen e caktuar afersisht 2 vite.”:

40. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të anulohen Aktgjykimi [Rev. nr.74/2021] i Gjykatës Supreme, Aktgjykimi [A.nr.5433/20 17] i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi [C.nr.298/2016] i Gjykatës Themelore; (iii) të obligohet e paditura Drejtoria e Policisë së Kosovës që parashtruesit, në emër të 50% të pagës së ndaluar, qershori 2011 e deri në shkurt 2013, t’ia kompensojë shumën prej 7,192.50 euro me kamat ligjore dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 854 euro e mbështetur ne ekspertizën e caktuar nga gjykata e shkallës së parë; si dhe (iv) ta kthejë lëndën në rigjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

1. *Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*
2. *Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 29
[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

[...]

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.
5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj

[...]

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54 **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 55 **[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]**

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*
- 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*
- 3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*
- 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*
- 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6 **(E drejta për një proces të rregullt)**

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të*

miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Ligji Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore i Republikës së Kosovës

Neni 14

Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjyimit të ligjshëm e të drejtë

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjyimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjyimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjyimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

[...]

Ligji Nr.03/L-212 i Punës i Republikës së Kosovës

Neni 73

Largimi i përkohshëm nga puna

- 1. I punësuari mund të largohet përkohësisht nga puna, kur:*
 - 1.1.ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale;*
 - 1.2. i punësuari është në vuajtje të paraburgimit;*
 - 1.3. kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj.*

Neni 74
Kompensimi i pagës gjatë largimit të përkohshëm

Gjatë kohës së largimit të përkohshëm nga puna, sipas nenet 73 të këtij ligji, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50%.

Neni 75
Kohëzgjatja e largimit të përkohshëm

Largimi i përkohshëm nga puna sipas nenet 73 të këtij ligji, mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë Kontratën e Punës.

Neni 78
Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

- 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.*
- 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.*
- 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.*

Neni 79
Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Neni 87
Afati i parashkrimit

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Kosovës

Neni 361
Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente

1. Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.
2. Megjithatë, të gjitha kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujditë e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e paraparë për parashkrimin e kërkesave periodike.

Udhëzim Administrativ Nr.15/2008-MPB për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës

**Neni 5
Sjellja e rëndë diskredituese**

Zyrtari policor dhe/apo stafi civil i Policisë së Kosovës është fajtor për sjellje të rëndë diskredituese, nëse:

[...]

5.12. Sillet në mënyrë të tillë duke i vënë hije të keqe apo të turpshme Policisë së Kosovës gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj;

[...]

**Neni 8
Korrupsioni**

Zyrtari policor dhe stafi civil i Policisë së Kosovës është fajtor për korrupsion nëse:

8.1. Në cilësinë e zyrtarit policor apo stafit civil të Policisë së Kosovës dhe pa autorizim përkatës në mënyrë direkte ose indirekte kërkon ose pranon ndonjë të mirë materiale, dhuratë, çfarëdo shërbimi, nënshkrimi ose rekomandimi;

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

43. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

44. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.74/2021] të 15 korrikut 2021, pasi që ka shteruar mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
45. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
46. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më

saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin K104/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih, gjithashtu, rastin K175/20, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

47. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi e pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”* të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet K140/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; K163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe K121/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021.
48. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin K104/21, cituar më lart, paragrafi 28).
49. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me faktin se parashtruesi i kërkesës ishte suspenduar me pagesë nga Policia e Kosovës në maj të vitit 2011, si rezultat i hetimit për shkelje të Ligjit për Policinë. Lidhur me këtë, kundër parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar dy procedura të ndara, penale dhe disiplinore, për të njëjtat vepra. Kundër parashtruesit të kërkesës u ngrit Aktakuzë nga Prokuroria Speciale për shkak të veprave penale *“Shpërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar”* nga neni 339, paragrafi 1 i KPRK-së, dhe *“Marrja e ryshfetit”* nga neni 343, paragrafi 1 i KPRK-së, për të cilat u shpall i pafajshëm nga Gjykata Themelore. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u vërtetua nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.347/13] të Gjykatës së Apelit me 18 gusht 2015. Në anën tjetër, në

procedurë disiplinore, në korrik të vitit 2013, Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkelje disiplinore dhe i shqiptoi masën disiplinore *"Ndalesë në pagë 30% për 2 muaj nga paga bruto"* si dhe masa plotësuese *"Transfer Administrativ"*. Ky vendim më pas u vërtetua edhe në shkallë të dytë nga Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime.

50. Parahtruesi i kërkesës në maj të vitit 2016 paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, duke kërkuar kompensimin e pagave të ndaluara për periudhën gjatë të cilës kishte qenë i suspenduar. Kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës u refuzua përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore si e pabazuar pasi që ishte paraqitur pas kalimit të afatit 3 vjeçar, aktgjykim ky i cili u vërtetua në shkallë të dytë nga ana e Gjykatës së Apelit. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe tejkalim të kërkesëpadisë. Lidhur me këtë, më 15 korrik 2021 Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se Aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë nuk ishin përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
51. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës e konteston specifikisht procedurën kontestimore dhe jo procedurën penale dhe atë disiplinore. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë vetëm çështjet që ndërlidhen me procedurën kontestimore.
52. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës e konteston Aktgjykimin [Rev.nr.74/2021] e Gjykatës Supreme, duke pretenduar në esencë shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenit 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, si rezultat i vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit.
53. Gjykata sjell në vëmendje se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me nenin 31 të Kushtetutës ka të bëjë me refuzimin e kërkesëpadisë së tij nga ana e gjykatave të rregullta, për kompensimin pagave të ndaluara sipas vendimit për suspendim, për të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht kanë zbatuar ligjin e aplikueshëm, meqenëse nuk kanë marrë parasysh aktgjykimin lirues në procedurën penale që ishte zhvilluar kundër tij.
54. Fillimisht, Gjykata rikujton se pretendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i ngritë në Gjykatë, të njëjtat i ka ngritur edhe para gjykatave të rregullta, pretendime të cilat kanë të bëjnë kryesisht me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit.

55. Në këtë kontekst, Gjykata në kuadër të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 shqyrton nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991, shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).
56. Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KI87/20, parashtrues *Suva Rechtsabteilung, Aktvendim* për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 57; KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
57. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Balıktas Bingöllü kundër Turqisë*, GJEDNJ, nr. 76730/12 i 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
58. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë*, kërkesa nr. 65167/01, Vendimi për pranueshmëri i 30 qershorit 2005; dhe rastet e Gjykatës të cituara më lart KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
59. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund

të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Päduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KIO5/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shogëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

60. Për më tepër, Gjykata vëren se lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për vendim të kundërligjshëm për suspendim në procedurë disiplinore pasi që ai ishte shpallur i pafajshëm në procedurë penale, Gjykata Supreme kishte specifikuar si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, në vlerësimin e saj thekson se nuk qëndrojnë pretendimet në revizion për shkeljet nga neni 182.2 pika "n" se paditësi është suspenduar kundërligjshëm me pagesë prej 50%, sepse çështja e gjykimit në procedurë penale dhe para organit të administratës në procedurë disiplinore edhe pse kanë lidhshmëri janë plotësisht të ndara njëra nga tjetra, nga ku rezulton se paditësi vetëm në procedurë penale është shpallur i pafajshëm e jo edhe në procedurë disiplinore.”

61. Në adresim të pretendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyetoi në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të cilave dispozita materiale ka nxjerrë aktgjykimin përkatës, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
62. Prandaj, duke marrë për bazë atë që është cekur më lartë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si këto interpretime të dispozitave përkatëse ligjore, të bëra nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta, kanë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme në rastin e tij apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare.
63. Në dritën e asaj çka u tha më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur se si vendimet e gjykatave të rregullta, në veçanti Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës bie në kategorinë e pretendimeve që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt” dhe si i tillë është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

64. Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 3, 24, 29, 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur mirë të GjEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi/ja thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (Vendim)* nr. 4241/03, të 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin *Baillard kundër Francës (Vendim)* nr. 6032/04, të 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi/ja nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe.
65. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 3, 24, 29, 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: Muhamet Idrizi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, KI125/19 parashtrues: Ismajl Bajgora, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63, dhe së fundmi rastin KI175/20, parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).
66. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 3, 24, 29, 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyeshme”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citon nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si dhe pse ishin shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

Përfundim

67. Në fund, Gjykata konkludon që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës i takon pretendimeve të kategorisë së “*shkallës së katërt*”, ndërkaq pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 3, 24, 29, 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës i përket kategorisë së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, dhe si të tilla, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 31 mars 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani